



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TROPOJË
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

SPECIFIKIME TEKNIKE

**PËR ASFALTIMIN, SINJALISTIKËN DHE VIJËZIMIN E RRUGËVE TË
LAGJEVE NË QYTETIN BAJRAM CURRI**

Objekti: Asfaltim, Sinjalistikë dhe Vijëzim Rruge Lagjeje të Qytetit Bajram Curri

1. Të përgjithshme

Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat minimale për materialet, teknologjinë e zbatimit, kontrollin e cilësisë dhe pranimin e punimeve për objektin në fjalë. Ato zbatohen së bashku me preventivin dhe relacionin teknik të objektit dhe janë të detyrueshme për kontraktorin.

Të gjitha punimet kryhen sipas rregullave teknike në fuqi, projektit të zbatimit dhe udhëzimeve të Mbikëqyrësit të Punimeve. Në rast mospërputhjeje ndërmjet dokumenteve, zbatohet kërkesa më e rreptë. Çdo material apo teknologji zëvendësuese miratohet paraprakisht me shkrim nga Mbikëqyrësi.

2. Punime përgatitore

Përpara asfaltimit, sipërfaqja ekzistuese pastrohet plotësisht nga pluhuri, balta, materialet e lira dhe çdo papastërti. Riparohen gropat dhe çarjet e mëdha, kompensohen uljet dhe verifikohen kuotat, pjerrësia tërthore dhe ajo gjatësore sipas projektit. Sipërfaqja lihet e thatë dhe e pastër përpara aplikimit të shtresës lidhëse.

3. Spërkatje me emulsion bituminoz (shtresa lidhëse)

Mbi sipërfaqen e përgatitur aplikohet spërkatje me emulsion bituminoz në normën 1 l/m², për të siguruar lidhjen ndërmjet shtresës ekzistuese dhe shtresës së re asfaltike. Emulsioni shpërndahet uniformisht mbi të gjithë sipërfaqen. Nuk lejohet qarkullimi mbi sipërfaqen e spërkatur para kryerjes së ndarjes/avullimit të emulsionit, si dhe nuk lejohet aplikimi në ditë me shi apo në sipërfaqe të lagësht.

4. Shtresa e binderit (asfaltobeton poroz), trashësi 6 cm

Materialet

Përzierja e binderit përgatitet me çakëll të thyer 60–75%, rërë 20–35% dhe pluhur mineral (filer), me bitum si material lidhës. Poroziteti mbetës pas ngjeshjes duhet të jetë 5–10% në vëllim. Agregatet plotësojnë STASH 539-87 (pastërti, formë kokrrizore, rezistencë në copëtim mekanik). Bitumi, sipas STASH 660-87, me penetrim 80–120 në stinë të nxehtë dhe 120–200 në pranverë/vjeshtë; temperatura e bitumit gjatë prodhimit nuk kalon 170°C. Pluhuri mineral ruhet i thatë dhe futet i shkrifët në përzierës; sasia e tij nuk kalon 15%.

Zbatimi dhe ngjeshja

Përzierja shtrohet e nxehtë me makineri asfaltoshtuese (finisher), në trashësi 6 cm pas ngjeshjes, duke ecur paralel me aksin gjatësor, për segmente pune deri në rreth 60 m. Ngjeshja fillon menjëherë pas shtrimit, sa më e nxehtë: në kohë të nxehtë me rul 5–7 ton dhe më pas 10–12 ton, me shpejtësi

lëvizjeje 2–4 km/orë. Fugat gjatësore e tërthore me aksin bëhen të pjerrëta ($\sim 45^\circ$) dhe lyhen me bitum përpara vazhdimin të shtrimit ngjitur.

5. Shtresa e asfaltobetonit (shtresa veshëse/përdoruese), trashësi 4 cm

Materialët

Asfaltobetoni i ngjeshur përgatitet me çakëll të thyer e granit 35–40%, rërë rreth 50% dhe pluhur mineral 5–15%; poroziteti mbetës pas ngjeshjes 3–5% në vëllim. Përbërja e përzierjes (kurba granulometrike dhe përqindja e bitumit) përcaktohet paraprakisht në laborator dhe miratohet përpara prodhimit masiv, sipas STASH 660-87 dhe projektit të zbatimit.

Zbatimi

Shtresa veshëse shtrohet mbi shtresën e binderit, në trashësi 4 cm pas ngjeshjes, me të njëjtën teknologji (finisher, ngjeshje me rul, kontroll temperaturash dhe trajtim fugash). Sipërfaqja përfundimtare duhet të jetë e rrafshët, pa valëzime e pa vendgrumbullime, me pjerrësi tërthore që siguron largimin e ujërave sipërfaqësore anash rrugës. Shtrimi nuk lejohet në ditë me reshje shiu apo në temperatura shumë të ulëta.

6. Transporti i materialeve

Binderi dhe asfaltobetoni transportohen nga impianti deri në kantier me automjete të pastra dhe të mbuluara me tendë, për ruajtjen e temperaturës së përzierjes. Distanca mesatare llogaritëse e transportit është 40 km. Materiali duhet të mbërrijë në kantier brenda temperaturave teknologjike të lejuara për shtrim.

7. Sinjalistika vertikale

Sinjalet dhe tabelat prodhohen e vendosen sipas Kodit Rrugor (Ligji Nr. 8378/1998) dhe Rregullores së Zbatimit, Manualit të Sinjalistikës dhe SSH EN 12899-1. Trupi metalik i shenjës është prej llamarine hekuri me trashësi jo më pak se 1 mm, ose prej aliazhi alumini jo më pak se 2,5 mm, i përforcuar në të gjithë perimetrin. Sipërfaqja mbulohet me material retroreflektues të certifikuar, me klasë reflektimi sipas kategorisë së rrugës; ngjyrat, simbolet dhe përmasat sipas standardit. Shenjat fiksohen në bishtin/shtyllën mbajtëse të betonuar në themel, në lartësinë dhe pozicionin e përcaktuar nga Kodi Rrugor.

Për objektin parashikohen këto elemente të sinjalistikës vertikale:

- Sinjale “emër rruge”, LxH e vogël 60x20 cm;
- Sinjale të drejtimit urban, HxL e vogël 20x100 cm;
- Tabela sinjalizuese trekëndore paralajmëruese, A=60 cm;
- Tabela tetëkëndore “STOP” (shenjë ndalimi);
- Tabela rrethore “detyrim”, Ø60 cm;
- Përvijues normalë anësorë, 30x30 cm.

8. Vijëzimi horizontal

Vijëzimi realizohet me bojë termoplastike të aplikuar në të nxehtë, me shirita gjatësorë e anësorë me gjerësi 12 cm. Për segmentin ku parashikohet, aplikohet edhe bojë termoplastike (pastë) për shenja dhe vija të bardha. Materiali termoplastik plotëson kërkesat për retroreflektim (me shtim mikrosferash qelqi), rezistencë ndaj rreshqitjes dhe qëndrueshmëri në kohë, sipas SSH EN 1436/EN 1871.

Sipërfaqja para vijëzimit duhet të jetë e pastër, e thatë dhe e kuruar (asfalt i saposhtruar duhet të kalojë kohën e nevojshme). Vijat realizohen të vazhdueshme ose të ndërprera sipas projektit, me buzë të qarta, gjerësi e pozicion konform Kodit Rrugor. Nuk lejohet aplikimi në kushte lagështie ose temperature të papërshtatshme.

9. Kontrolli i cilësisë dhe pranimi i punimeve

Për çdo segment rruge mbahet akt-teknik, ku pasqyrohen të dhënat e kontrollit: trashësia e shtresave (binder 6 cm, asfaltobeton 4 cm), temperaturat e shtrimit, ngjeshja, kuotat dhe pjerrësitë. Kontrollohen rrafshësia e sipërfaqes, poroziteti mbetës dhe përbërja e përzierjes nëpërmjet kampionëve laboratorikë. Për sinjalistikën verifikohen dimensionet, ngjyrat, retroreflektimi dhe pozicioni; për vijëzimin verifikohen trashësia, gjerësia (12 cm) dhe retroreflektimi. Punimet që nuk plotësojnë kërkesat riparohen ose zëvendësohen me shpenzime të kontraktorit.

10. Siguria në punë dhe menaxhimi i trafikut

Gjatë punimeve zbatohen masat e sigurimit teknik sipas Kodit Rrugor dhe Rregullores së Zbatimit. Vendoset sinjalistikë e përkohshme (ngjyrë e verdhë) dhe, sipas nevojës, llamba pulsante, duke siguruar rrjedhshmërinë e trafikut dhe sigurinë e këmbësorëve. Punëtorët pajisen me veshje mbrojtëse reflektive. Fillimi i punimeve autorizohet vetëm pas marrjes së masave mbrojtëse të nevojshme.

11. Matja dhe njësitë e punimeve

Punimet maten dhe pranohen sipas sasive realisht të realizuara e të pranuar, në përputhje me projektin dhe preventivin, sipas njësive:

- Spërkatje me emulsion bituminoz — m²;
- Shtresë binderi 6 cm — m²;
- Shtresë asfaltobeton 4 cm — m²;
- Transport binder + asfaltobeton — t·km;
- Tabela, sinjale dhe përvijues — copë;
- Vijëzim me shirita termoplastikë — ml;
- Bojë termoplastike (pastë) — m².

GRUPI I PUNËS / DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Tek. Mustaf VATOCI

Ark. Endrit MUSAJ

Ing. Egzon MUHAMETAJ

MIRATO I
KRYETARI I BASHKISË TROPOJË
REXHË BYBERI

